

VENDIM
Nr.503, datë 1.8.2007

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET FUNKSIONALE TË QENDRËS
KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT¹**

(Ndryshuar me VKM nr.756, datë 16.9.2015; nr.392, datë 3.5.2017)

(I Përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 13 të ligjit nr.9732, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e tarifave për shërbimet funksionale të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1

(Ndryshuar pika 11, shtuar 11/1 dhe 11/2 me VKM nr. 756, datë 16.9.2015; shtuar pika 21 me VKM nr.392, datë 3.5.2017)

	Shërbimi	Tarifa në lekë
1	Verifikimi i mundësisë së regjistrimit të emrit	100
2	Rezervimi i emrit	100
3	Transferimi i emrit të rezervuar	100
4	Regjistrimi fillestar me formular-statut regjistrimi	100
5	Regjistrimi fillestar me statut të përgatitur nga palët	100
6	Regjistrimet e tjera të detyrueshme	100
7	Regjistrimi me kërkesë të çdo të treti të vendimeve të autoritetit publik, (përveç atyre të bëra nga vetë subjekti)	0
8	Regjistrime vullnetare	100
9	Çregjistrimi	100
10	Lëshimi i ekstrakteve për një të dhënë të regjistrit tregtar	100
11	Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt me 1 fletë deri në 20 fletë	100
11/1	Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt, me 21 fletë deri në 100 fletë	500
11/2	Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt, mbi 100 fletë	1 000
12	Lëshim ekstrakti për gjendjen e subjektit	100
13	Lëshimi i kopjes së statutit	100

¹ VKM nr.503, datë 1.8.2007 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.113 datë 28 gusht 2007.
VKM nr. 756, datë 16.9.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.168 datë shtator 2015.
VKM nr.392, datë 3.5.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.105 datë 11 maj 2017.

14	Lëshimi i kopjes së bilancit	100
15	Lëshimi i kopjes së listës së aksionarëve	100
16	Lëshimi i kopjeve të dokumenteve të tjera shoqëruese (vetëm të një dokumenti)	100
17	Lëshimi i dublikatës së certifikatës	100
18	Lëshimi i të dhënave për adresën e banimit të individëve, të njoftuar në QKR, sipas ligjit	100
19	Aplikimi për licencë nëpërmjet QKR-së	1
20	Çdo veprim tjetër i parashikuar nga ligji dhe i pa përmendur më sipër	100
21	<i>Kryerja e veprimeve nëpërmjet sportelit elektronik</i>	0